

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE
“ALBA INERTE & KONSTRUKSION” SHPK

Sot më datë 25/01/21, ne përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme ortakët e nënshkruajnë dhe miratojnë këtë Statut me qëllim krijimin e Shoqërisë “Alba Inerte&Konstruksion” shpk, me përmbajtje si me poshtë.

TITULLI I

Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia dhe hapësira në internet

Neni 1: Data e themelimit, emërtimi dhe ortakët

Emri i Shoqërisë së re të krijuar është “Alba Inerte&Konstruksion” Shpk. (këtu e më poshtë Shoqëria). Ortakë zoterues të dy kutave që përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë janë:

- **Znj. Reita Haçkaj**, e bija e Ilirit dhe Irmës, lindur më 17.12.1988, në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në adresën: Rruga Myrtezim Kellici, 3/1, Tiranë, mbajtëse e pasaportës me nr. BC7560074, me nr. Personal I86217046L, zoteruese e një kuotë, që përfaqëson 49% (Dyzet e nente përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
Dhe
- **Shoqëria “ALBA BETON” SHPK, përbërë nga ortakët:**
 - **Z. Adrian DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikes, lindur më 05 Shkurt 1960, në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, banues në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, kati i 17, Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 028000393, me datë lëshimi 15.12.2009, zotërues i një kuote që përfaqëson 29.7% (njëzetë e nëntë pikë shtatë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
 - **Z. Artan DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikes, lindur më 30 Maj 1965, në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga “Pjetër Bogdani” Nr. 24/2, Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 028592335, me datë lëshimi 09.03.2010, zotërues i një kuote që përfaqëson 30.6% (tridhjetë pikë gjashtë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

- **Z. Genci DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikës, lindur më 19 Dhjetor 1967, në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, banues në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, kati i 17, Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 028470070, me datë lëshimi 16.02.2010 zotërues i një kuote që përfaqëson 29.7% (njëzetë e nëntë pikë shtatë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- **Z. Erjon HARIZI**, i biri i Refatit dhe Xhezares, lindur më 19 Tetor 1979 në Lumas, Berat, banues në adresën Rr “Don Bosko, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal H91019106G, zotërues i një kuote që përfaqëson 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, i cili sipas Vendimit nr. 04, datë 10.09.2020, të Asamblesë së Shoqërisë “Alba Beton” shpk, autorizohet të nënshkruajë këtë statut në emër dhe për llogari të kësaj Shoqërie.

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet tregtar sipas objektit të veprimtarisë përshkruar më poshtë:

- Prodhim i inerteve dhe shitja e tyre;
- Transporti dhe magazinimi i inerteve për vete ose për të tretë;
- Te tjera të ndryshme në funksion të aktivitetit dhe vendimmarrjes së ortakëve.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Rruga 5009 (pesëmijë e nente), Lagja Qarri, Zall Herr, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

TITULLI II

Kapitali

Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar




Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 10'000 lekë (dhjetë mijë), i përbërë nga 2 (dy) kuota.

(1) Kontributi i ortakëve në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

- Ortaku, Znj. Reita Haçkaj është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4'900 Lekë (katër mijë e nëntëqind), e cila përbën 49% (Dyzet e nente perqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë”.
- Ortaku, Shoqëria “Alba Beton” shpk është zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5'100 Lekë (pesë mijë e njëqind), e cila përbën 51% (Pesedhjetë e një perqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë”.

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara

(1) Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën katërmëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, siç përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpashëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkarisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit të cilat lidhen me këtë kuotë.

(3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interesi prej 4%.

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se katërmëdhjetë ditësh të tjera personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet detyrimi, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, anulohen.

(5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të Administratorit dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderohet e arsyeshme nga Asambleja e Ortakëve.

(7) Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75% (shtatedhjetë e pese përqind) të kapitalit) të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të Shoqërisë.

(2) Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi, me argumentin se nuk është respektuar e drejta e parablerjes.

(3) Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, sipas pikës 2, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në Shoqëri, i dërgon marrësit njoftimin për mospranimin.

Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit

(1) Nëse një ortak vdes bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e

ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkarisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesi vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër.

(3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesi i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

(2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit. Në rast zvogëlimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

Neni 12: Blerja e kuotave nga ortakët dhe të tjerët

(1) Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për blerjen e kuotës/pjesë të kuotës që shitet nga një ortak kundrejt personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet edhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Ortaku jep ofertën brenda 60 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 60 ditëve. E

drejta e parablerjes duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblesë.

(2) E drejta e parablerjes është proporcionale në raport me përqindjen e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten.

(3) Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 ditëve, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

TITULLI III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 13: Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme dhe vendim-marrja

(1) Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojë të arsyeshme vetë dhe duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Ligjin.

(2) Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota kalendarike përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

(4) Përveç rasteve të përmendura në këtë statut, kërkohet vota pro e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 75% të kapitalit për çështjet e mëposhtme:

- a. Ndryshimi i statutit;
- b. Shpërndarjen e fitimit;
- d. Riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërisë

Neni 14: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Ligj. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Ligjit. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratorët caktojnë një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse asnjëri prej Administratorëve nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse asnjëri prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër

vendimit.

(8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

Neni 15: Votat e ortakëve

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi ka të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit vendimi i të cilit merret bazuar në Statut.

Neni 16: Hetimet e posacme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posacëm sipas Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e Shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

TITULLI IV

Administratorët

Neni 17: Emërimi i administratorëve

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë për një afat të caktuar. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator, me të drejtë riemërimi. Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Ligj.

Neni 18: Kompetencat e Administratorëve

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratorët, të cilët mund t'i ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Ligji. Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë e mëvonshme nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të

ishin dhënë direktiva.

- (2) Administratorët nuk mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre dikujt tjetër. Kjo është kompetencë ekskluzive e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilën janë dakord ortakët që përfaqësojnë 75% të kapitalit.
- (3) Administratori/ët nuk mund të delegojnë asnjërin prej detyrimeve të cilat ua ngarkon ligji.
- (4) Administratori/ët kanë këto kompetenca e kufizime:
- a) Në rastin kur Shoqëria ka dy administratorë, çdo veprim i Shoqërisë duhet të kryhet nga të dy Administratorët së bashku, përveç nëse secili prej tyre i jep tjetrit të drejtën, nëpërmjet një prokure, për të kryer i vetëm veprimet/transaksionet.
 - b) Në rastet e tejkallimit të limiteve të përcaktuar në këtë paragraf operacioni përkatës do të miratohet me vendim të posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me votat e ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit.
 - c) Administratori i Shoqërisë, me miratimin e Asamblesë së Ortakëve që përfaqësojnë jo më 75% të kapitalit të Shoqërisë, do të nënshkruajnë çdo marrëveshje tregtare ose kontrate nëpërmjet se cilës Shoqëria përfiton ose tjetëron pasuri të paluajtshme në kuadër të marrëdhënieve të shkëmbimit mall/shërbim/send me mall/shërbim/send (kling);
 - d) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruajë kontratë shitje apo dhënie me qira të aseteve të Shoqërisë, kontratë dhënie apo marrje huaje apo kredie, apo çdo kontratë tjetër që përbën një kredi ose debi për shoqërinë, përveç nëse një e drejtë e tillë jepet me një vendim miratues të Asamblesë së Përgjithshme me votat e ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit.

Kufizimet e mësipërme nuk janë të aplikueshme për transaksione që kanë për qëllim pagesat e detyrueshme të lidhura me administrimin e zakonshëm të aktivitetit të Shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në pagesën e taksave, tarifave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë, pagat e punëmarrësve, detyrimet për furnitorët e energjisë elektrike dhe ujit, gjobat dhe penalitetet që lidhen me to, të cilat Administratori mund t'i kryejë vetë.

Neni 19: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë 100% të kuotave.

Neni 20: Kufizimet për votimin



(1) Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas Ligjit, nëse me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
2. ta autorizojnë të vendosë për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote.

Neni 21: Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorëve

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë procesverbalet e të gjithë takimeve/mbledhjeve të bëra nga Administratori.

KAPITULLI V

Dividentët dhe kapitalizimi i fitimeve

Neni 22: Dividentët

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të Ligjit, Shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividente me përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhen në përputhje me përqindjen takuese të secilit ortak. Por, nëse një kuotë emetohen me kushtin se përfiton divident duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividentin sipas këtij kushti.
- (3) Secili ortak mund t'i paraqes kërkesë administratorit që në Mbledhjen e Asamblese për miratimin e rezultateve financiare dhe destinimin e të ardhurave vjetore të merret në shqyrtim pagimi i dividentit që do t'i përkiste këtij ortaku. Në rast se pagesa e dividentit është e pranueshme në përputhje me rezultatet e aktivitetit të shoqërisë si dhe në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe Ligjit për shoqëritë teregulare, Administratori e përfshinë kërkesën e ortakut në rendin e ditës të Mbledhjes së Asamblese së Ortakëve. Ortakët nuk mund të pengojnë, qoftë edhe me vendim të veçantë të shumicës, pagimin e dividentit për një apo disa ortakë të cilët kërkojnë shpërndarjen e dividentit.
- (4) Asnjë divident dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë

interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

Neni 23: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Ligji, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të Shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividende preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

TITULLI IV

Prishja dhe Njoftimet

Neni 24: Prishja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme që përbën 75% të kapitalit të Shoqërisë, dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajnë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojnë pasuritë dhe të përcaktojnë se si do të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 25: Njoftimet

(1) Njoftimet që i jepen ortakëve ose që ata bëjnë sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik.

(2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortakut ose personalisht ose duke ia nisur me poste në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje Ligjin.

Neni 26: Dispozita të përgjithshme

Përsa i përket çështjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Legjislacionit në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje që del nga ky Statut, nëse nuk zgjidhet me marrëveshje mes palëve, do të zgjidhet para gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 27: Dispozita përfundimtare

Ky Statut përpilohet në 6(gjashtë) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 27 (Njëzet e shtatë) nene. Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKR.


Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

Emrat dhe Nënshkrimet e Ortakëve Themelues të :
Shoqërisë Tregtare "ALBA INERTE & KONSTRUKSION" SH.P.K.

Znj. Reita HAÇKAJ

Handwritten signature of Reita Hackaj in blue ink, written over a horizontal line. The signature is stylized and includes the year '2020' at the bottom right.

Z.Erjon HARIZI

Handwritten signature of Erjon Harizi in blue ink, written over a horizontal line. The signature is stylized.